



**PROJEKT ZBATIMI I UJESJELLESIT  
RAJONAL I FINIQIT  
(LINJA E JASHTME NGA BURIMET E  
MERKOS)**

**RAPORTI TEKNIK DHE SPECIFIKIMET  
TEKNIKE**

**Punoi: "HMK CONSULTING" sh.p.k Porosites: BASHKIA FINIQ**

**Ing.Ferdinant SHAHINLLARI**

**Ing. Jurgen OCELLI**

**Tirane 2018.**

**PERMBAJTJA E RAPORTIT**

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>2. OBJEKTI I STUDIMIT .....</b>	<b>4</b>
<b>3. DETYRA E PROJEKTIMIT,ZONA E PROJEKTIT, QELLIMI DHE PRITSHMERITE NGA SHERBIMET E KONSULENCES DHE KRITERET E PROJEKTIMIT .....</b>	<b>5</b>
3.1 DETYRA E PROJEKTIMIT DHE KERKESAT E SAJ PER HARTIMIN E PROJEKTIT .....	5
3.2 PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE.....	5
3.3 QELLIMI I INVESTIMIT .....	5
3.4 QELLIMI I SHERBIMEVE TE KONSULENCES.....	5
3.5 REZULTATET E PRITSHME .....	5
3.6 PRODUKTET E SHERBIMEVE TE KONSULENCES .....	6
3.7 KRITERET E PROJEKTIMIT .....	6
3.8 ZONA E PROJEKTIT .....	8
<b>4. HIDROGJEOLIGJIA E BURIMIT TE MERKOS .....</b>	<b>9</b>
<b>5. SKEMAT ALTERNATIVE KRAHASIMI I TYRE DHE PERZGJEDHJA E VARIANTIT PERFUNDIMTAR.</b>	<b>9</b>
5.1 HISTORIKU I PROJEKTIT.....	9
5.2 HARTIMI I PROJEKTIT TE RI DHE ZGJIDHJA E SKEMES PERFUNDIMTARE.....	10
<b>6. LLOGARITJET HIDRAULIKE TË SISTEMIT.....</b>	<b>12</b>
6.1 PËRCAKTIMI I LLOJIT DHE NUMRIT TË PËRDORUESVE.....	12
6.2 LLOGARITJA E KËRKESËS PËR UJË .....	16
6.2.1 Kërkesa për ujë kundër zjarrit .....	16
<b>7. STACIONI I POMPIMIT.....</b>	<b>19</b>
7.1 STACIONI EKZISTUES PRANE BURIMIT TE MERKOS .....	19
7.2 STACIONI I RI DHE REHABILITIMI I ATIJ EKZISTUESLLOGARITJA E POMPAVE NE STACIONIN E POMPIMIT .....	22
7.3 PAJISJET E FRUNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE QE DUHEN.....	26
<b>8. ANALIZA E GJENDJES SE PAQENDRUESHME TE SISTEMIT .....</b>	<b>27</b>
Fikja e pompes, pa masa mbrojtese kundrejt grushtit hidraulik per stacionin ne pandejlemon .....	29
Fikja e pompes, me pajisje mbrojtese kundrejt grushtit hidraulik .....	30
Saracineskat:.....	32
Pajisja e mbrojtjes kunder grushtit hidraulik.....	37
<b>9. PARAMETRAT E PROJEKTIMIT PER SISTEMIN E FURNIZIMIT ME UJE .....</b>	<b>39</b>
9.1 PARAMETRAT E PROJEKTIMIT DHE KONSIDERATAT .....	39
9.2 MATERIALET DHE KERKESAT E PROJEKTIMIT .....	42
<b>10. REZERVUARËT.....</b>	<b>42</b>
10.1 8.1 REZERVUARËT EKZISTUES GRUMBULLUES DHE SHPERNDARES .....	42
10.2 PËRCAKTIMI I VËLLIMIT TË REZERVUARËVE TË RI.....	42
10.3 REZERVUARI GRUMBULLUES MBI FSHATIN PANDEJLEMON .....	51
<b>11. PËRMASIMI I LINJAVE TË UJËSJELLËSIT .....</b>	<b>53</b>
11.1 KRYERJA E LLOGARITJEVE ME ANË TË PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE.....	54
<b>12. TE PERGJITSHME PER PUNIMET CIVILE .....</b>	<b>58</b>
12.1 TË PËRGJITHSHME.....	58
12.2 SHTRIMI NË KANAL .....	58
12.3 MJETET SHTRUESË TË TUBACIONIT DHE PËRDORIMI I SAKTË I TYRE .....	59
12.4 TESTI PARAPRAK.....	59
12.5 MËBAJTJA DHE TRANSPORTIMI I TUBAVE NË ZONË .....	60

**UJËSJELLESI RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E  
MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

---

12.6	GËRMIMI DHE MBUSHJA .....	60
12.7	PËRFORCIMI DHE VESHJA E GËRMIMEVE .....	63
12.8	HEQJA E MATERIALEVE TË TEPËRTA NGA GËRMIMI.....	63
12.9	NDËRTIMI I PUSHTAVE.....	63
12.10	PËRSHKRIMI I ÇMIMIT NJËSI TË TUBAVE PËR KANALIZIMET.....	64
12.11	PËRSHKRIMI I ÇMIMIT NJËSI PËR PUSHTAT .....	64
12.12	TUBACIONET E POLIETILENIT .....	64
	12.12.1 Prodhimi .....	64
	12.12.2 Kontrolli i cilësisë së prodhimit.....	65
	12.12.3 Saldimet e tubave të polietilenit.....	66
<b>13.</b>	<b>PREVENTIVI I PUNIMEVE .....</b>	<b>68</b>

## **1. HYRJE**

- Zona Gjeografike:

Bashkia e re e Finiqi kufizohet në veri me bashkinë Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiqi.

- Popullsia:

Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë për km<sup>2</sup> ndërsa në bazë të regjistrimit civil densiteti është 88.51 banorë/km<sup>2</sup>. Finiqi është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrezomës së Vurgut. Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo zonë ka përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi.

- Bujqësia dhe infrastruktura:

Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit. Infrastruktura e Bashkisë është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkufitare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.

## **2. OBJEKTI I STUDIMIT**

Objekti i këtij studimi është hartimi i projekt zbatimit të ujësjellsit rajonal Livadhja dhe fshatrat përreth, Bashkia Finiq, ku në këtë fazë do të hartohet vetëm rrjeti i jashtëm (nga burimi i Merkos deri në depot e fshatrave sipas skemës të paraqitur në vizatimet e projektit) në fshatin Livadhja dhe fshatrat përreth. Në këtë skemë përfshihen fshatrat:

1. *Karroqi*
2. *Ninat*
3. *Markat*
4. *Qesarat*
5. *Grava*
6. *Komati*
7. *Pandjelemoni*
8. *Kalcati*
9. *Llazati*
10. *Livadhja*
11. *Kodra*
12. *Kullurica*
13. *L.Talo*
14. *Sopiku*
15. *Vagalati*

Persa i përket rrjetit të brendshëm të fshatrave janë në gjendje që kanë nevojë për amortizim.

Nje project I tille eshte hartuar qe ne kohen e sistemit te kaluar nga insituti ne vitn 1987 I cili ka mbetur ne leter dhe I pa realizuar. Skema e furnizimit te ujit ka ndryshuar nga ai project pasi fshtrat kane pesuar levizje demografike dhe per pasoje dhe normat e ujit kane ndryshuar gje qe pasqyrohet edhe ne sasine e ujit. Depot ose rezervuaret e fshtrave me poshte eshte menduar qe te furnizohen me sistemin me ngritje mekanike me stacion pompimi nga burimet deri ne kuoten 350 m ne Pandjelemon dhe me veterrjedhje pastaj te gjitha depot qe mund te furnizohen nga kjo kuote.

### **3. DETYRA E PROJEKTIMIT,ZONA E PROJEKTIT, QELLIMI DHE PRITSHMERITE NGA SHERBIMET E KONSULENCES DHE KRITERET E PROJEKTIMIT**

#### **3.1 DETYRA E PROJEKTIMIT DHE KERKESAT E SAJ PER HARTIMIN E PROJEKTIT**

Me fondet nga burimet e buxhetit te Shtetit Shqiptar eshte parashikuar te kryhen Sherbimet e Konsulences per objektin: “Studim projekti i ujesjellsit Rajonal Bashkia Finiq”.

#### **3.2 PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE**

Sipas informacionit te dhene ne detyren e projektimit kjo zone furnizohet nga nje stacion pompimi i ndertuar rreth viteve 1987-1988. Skema eshte me e alternuar ku uji ngrihet me ngritje mekanike deri ne kodren e Pandjelemonit kuota 350m si kuota me larte e mundshme per te krijuar presionin e mjaftueshem per te furnizuar Depot e tjera te ujit.

Fshatrat si Qesarat-Grave, Ninat Markat Krraq furnizoheshin nga direkt nga stacioni pompmit, nders fshtrat e tjere uji kalon ne ujemledhsi e Pandjelemonit dhe pastaj shperndahet ne depot e tjera

Sic e permende gjendja e rrjete te jashtem te keaj zone eshte totalisht e amortizuar si linjat stacioni i pompimit jashte funksionit si dhe depo te cilat jane prej mur guri dhe jashte sherbimit dhe cilesis e per furnizim me uje te pijshem.

#### **3.3 QELLIMI I INVESTIMIT**

Qëllimi i përgjithshëm i investimit është përmirësimi i kushteve të jetesës së popullatës në zonat që mbulon Ujesjellesi ku mbulohen rreth 15 fshatra me nje popullsi 9520 banore

Investimi synon sigurimin e furnizimit me ujë të sigurt, higjenikisht të pastër me mbulimin e kostos dhe tarifate pranueshme socialisht për zonat e përzgjedhura në zonën e studimit.

#### **3.4 QELLIMI I SHERBIMEVE TE KONSULENCES**

Qëllimi i këtij shërbimi është kryerja e Studim-Projektimit të rehabilitimit te stacionit te pompimit, duke perfshire të gjithë komponentet përbërës të këtij sistemi per te siguruar prurjet e nevojshme per mbulimin e nevojave te zones per sot dhe te perspektives 25 vjecare.

#### **3.5 REZULTATET E PRITSHME**

Rezultatet qe priten nga projekti jane:

- Sigurimi i prodhimit të stacionit të pompimit për të mbuluar nevojat për ujë të sistemit aktual sipas nevojave duke nderhyrë dhe në fazën e dytë në rrjetin e brendshëm pasi dhe ai rrjet është i amortizuar.
- Sigurimi i transferimit të ujit nga burimi në depon grumbulluese të Stacionit të pompimit
- Zevendesimi i pompave ekzistuese me të reja duke siguruar furnizimin e sistemit shpërndarës me sasine e duhur të ujit në fazën e dytë të investimit
- Sigurimi i kushteve të pershtatshme për stafin e operimit në stacionin e pompimit të Ujesjellesit

### **3.6 PRODUKTET E SHERBIMEVE TE KONSULENCES**

1. Hartimin e projekt-idesë paraprake dhe përfundimtare për zonën ku do kryhet rehabilitimi
2. Hartimi i projektit të zbatimit të rehabilitimit kaptazhit dhe Stacionit të Pompimit dhe linjave të furnizimit të stacionit të pompimit në kuadër të të cilit do të kryhen:
  - ✓ Projekti i rehabilitimit të st.pompave ose ndertimi i një të riu apo shtese sipas nevojave
  - ✓ Zëvendësimin e linjave të furnizimit të stacionit të pompimit nga stacioni deri në puseten hyrëse e deri në rezervuarët grumbullues dhe shpërndarës
  - ✓ Rehabilitimin i Stacionit kryesor nga pikepamja ndertimore
  - ✓ Projektimi i pompave të reja duke zëvendësuar pompat ekzistuese me të gjithë aksesoret elektrike dhe mekanike
  - ✓ Ri-konstruksionin i ndertesave të shërbimit dhe operimit të stacionit të pompimit
3. Studimin e VNM
4. Projektin e lejës së ndërtimit

### **3.7 KRITERET E PROJEKTIMIT**

Në detyrën e projektimit janë dhënë kriteret e mëposhtme të projektimit:

- Popullsia e shërbimit nga Ujesjellesi është 9520 banorë
- Rritja natyrale e popullsisë të merret 2% në vit
- Kriteret e projektimit të bazohen në KTP e projektimit të ujësjellës kanalizime në fuqi si dhe eurocodeve
- Normat e ujit të pijshëm të merren si bazë në projektimin e ujësjellësave dhe të furnizimit me ujë të qendrave të banuara

- Normat e përdorimit të ujit për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra, të lagjeve të rrugëve dhe të shesheve
- Normat e përdorimit të ujit për kërkesat kundër zjarrit
- Llogaritja e kërkesës së ujit të bazohet në njësinë litër/ banor në ditë, shtret/në ditë për hotelet nese ka.
- Projektimi të realizohet për një horizont planifikimi 25 vjeçar dhe duke marrë parasysh faktorët e rritjes se popullsisë prej 2% ne vit.

Vleresimi i kerkeses per uje bazohet ne kriteret e projektimit dhe standartet ne fuqi. Aktualisht ne Shqiperi nuk kemi nje standart apo rregullore te miratuar zyrtarisht per percaktimin e nevojave per uje per qellime te ndryshme. Ne mungese te tyre jane marre ne konsiderate dokumente te ndryshme qe japin vleresime te ndryshme per nevojat per uje te cilat po i permbledhim ne tabelen 7.1 me poshte.

**UJËSJELLESË RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

Nr.	Kriteri	Vlera	Koment
1	Periudha e Projektimit	25vite	Sipas detyres se projektimit
2	Norma e nevojave per uje l/person/dite dhe nevoja publike	250 l/p/d	Sipas VKM Nr 722 (250 l/p/d per qytetet me popullesi 10,001 – 50,000 banore)
2	Norma e nevojave per uje l/person/dite	110-150 l/p/d	Sipas KTP – 11 - 1978
3	Nevojat per uje nga Bizneset/ Institucionet/ njesite Industriale	Perfshire ne neojat per banore ne dite per popullesi < 2,000 banore 10% e konsumit per banore ne dite per popullesi ≥ 2,000, < 5,000 banore 20% e konsumit per banore ne dite per popullesi ≥ 5,000 inhabitants	Sipas analizave te nevojave per uje ne Shqiperi kur mungojne te dhenat per konsumin per njesite
4	Normat e ujitjes se siperfaqeve te gjelberuara ne qytete	14-18 l/m <sup>2</sup> siperfaqe te gjelberuar	Sipas KTP – 11 - 1978
5	Koeficienti I jouniformitetit ditor	$f_d = 3.9 \times E^{-0.0752} = 1.744$	Standarti Gjerman per Ujesjellesat DVGW W410
7	Koeficienti I jouniformitetit orar	$f_h = 18.1 \times E^{-0.1682} = 2.993$	Standarti Gjerman per Ujesjellesat DVGW W410
8	Humbjet teknike	20%	Sipas praktikës se projektimit ne Shqiperi
8.1	Kumbjet ne tubacionin e dergimit	3-5%	
8.2	Humbjet ne systemin shperndares	15-17%	

**Table 3-1 Kriteret e projektimit dhe vlerat e konsideruara per vleresimin e nevojave per uje**

### 3.8 ZONA E PROJEKTIT

Zona e projektit do te jete ajo e zones Bashkise Finiq bashkengjitur keni nje planvendosje mbi ortofoton e fundit viti 2015.



#### **4. HIDROGJEOLIGJIA E BURIMIT TE MERKOS**

Fshatrat Karroq, Janjar, Markat, Minat, Qesarat, Grave, Komat, Pandejlemon, Halo, Kalcat, Kullurice, Livadhja, Sopik, Lefter, Talo, Qenurja, Pllake, Dobre, Vagalat, Vargu i ri, Duke mos patur mundesitjeter, do te furnizohen me uje ne ujesjelleste centralizuar me ngrtije mekanike nga burimii Markos.

Per furnizimn me uje te ketyre fshatrave kerkohej nje sasi uji prej 17 l/sek ne projektin e vitit 1987.

Burimi i Markos-del ne krah te djathte te rrjedhjes se lumit Pavlle, pothuajse ne kontakt te gelqeroreve pllake holle, te care me zhavorret e lumit ne kuote 100-120m.

Burimi del ne nje front mr gjatesi rreth 100m. Eshte i kapur me ane ten je kanali me mur betonit, pjeserisht i mbuluar me pllaka. Uji i burimit perdoret per vaditje.

Burimi ushqehet kryesisht nga gerqeroret por nuk perjashtohet ushqimi dhe nga ujrata e lumit, ne pjeset e siperme te rrjedhjes. Ne periudhen me rreshje te fuqishme, dalja ne juglindja e burimit turbullohet. Prurja e burimit me dt 10 Qershor 1987 ishte 1.5m<sup>3</sup>/sek. Nga ana organo-leptike uji eshte i mire. Ai eshte pa ngjyre, pa ere pa shije dhe transparent. Nga ana e perberje kimike uji rezulton shum i mire. Te gjitha elementet te analizuar jane mbrenda kondicioneve te perdorimit te ujit per pirje. Mineralizimi i pergjithshem eshte 369.8mg/l, mbetja e thate 237mg/l, fortesia e pergjithshme 10.5o gjermane dhe pH=7.4.

Nga ana bakteriale, sipas analizave te bera nga drejtoria e Higjenes dhe epidimologjie te rrethit te Sarandes uji rezulton i mire me MPN nga 0 deri 2.

Nga sa araqitem me lart rezulton:

1. sasia e ujit prej rreth 50 l/sek sigurohet nga burimi i Merkos

2. uji i burimit nga ana organo-leptike, kimike dhe bakterologjike eshte i mire dhe brenda kondicioneve te perdorimit te ujit per prijje.

3. Furnizimi i fshatrave te mesiperme nga burimi i Merkos kerkon ngritje mekanike me lartesi 230 - 250m.

4. Per vendosjen e valvoles, rekomandojme qe ne mesin e gjatesise se kanalit, Brenda ne kanal ose jashte tij te behet nje puset 1-1.5m dhe seksion 1x1 m ne rastin e hapjes se pusetes jashte kanalit, uji nga kanali ne pusete te dergohet ne kanal devijimi.

5. kanali me gjithë gjatesine e tij duhet te pastrohet si ne siperfaqe, ashtu dhe ne thellesi dhe te mbulohet e gjitha me pllake betony.

6. Per rreth burimit ne te dy anet e kanalit te krijohet brezi i mbrotjes se rrepte sanitare me distance jo me pak se 15 m.

#### **5. SKEMAT ALTERNATIVE KRAHASIMI I TYRE DHE PERZGJEDHJA E VARIANTIT PERFUNDIMTAR.**

##### **5.1 HISTORIKU I PROJEKTIT**

Ne vitin 1987 eshte realizuar nje projekt per furnizimin me uje te rajonit me afersisht 20 fshatra

Projekt ideja e ujesjellsit te 20 fshatrave te te zones se Merkos, Sarande eshte hartuar ne dy zgjidhje.

Zgjidhja e pare.

Parashikon marrjen e ujit nga burimi i Merkos per sasine 30.12l/sek dhe me stacion pompimi duke shfrytëzuar pjezometrin e krijuar ne degezim per piken me te larte per partitorin nr 3 (Markat) krijohet mundësia per te furnizuar me uje dhe ne tre drejtime te tjera.

- 1.Ne ate te Karroqit
- 2.Qesaratit , Grave
- 3.Partitori nr 1

Sipas kesaj zgjidhje nevojiten 447 ton . Tuba dhe nje fond prej 4.6 milion leke

Zgjidhja e dyte .

Parashikon marrjen e ujit nga i njeiti burim nga stac.pomp ( me grup pompash) partitorin nr 3 , depon Karroq , Qesarat dhe Grave. Me nje grup pompash te tjera ne te njeitin stacion pompash furnizohet partitori 1 me nje linje  $\Phi 200m/m$  qe shkon paralel me linjen  $\Phi 80m/m$  qe furnizon Qesaratin dhe graven me nje gjatesi 4.4km. sipas kesaj zgjidhje nevojiten ~576 ton tuba dhe nje fond prej 5.2 milion lekesh . Sipas detyres se projektimit u ndertua skeme-ideja e ujesjellesit te Merkos, per furnizimin me uje te fshatrave: Karroq, Janjar ,Ninat, Markat, Qesarat , Grove Komat, Pandelejmon, Llazar, Kalcat, Koder , Vagalat, Livadhja, Dober, Sepik, Lefter Talo, Kullurice , Halo, Pllake dhe Vargu i ri (Qenurja) me nje popullate ne fund te vitit 1986 prej 10546 banore.

Gjate hartimit te skeme-ideje, sipas detyres se projektimit eshte pasur parasysh qe keto fshatra te furnizohen me uje per nje periudhe perspektive prej 25 vitesh me nje norme uji prej 20 l/dite/banore dhe nje koeficient jouniformiteti  $k_j=2-2.33$  . Gjithashtu jane pare mundësite e furnizimit me uje si nga burimi i Merkos me nje prurje minimale  $min=100$  l/sek si nga pus shpimi ne Vargalat me nje prurje minimale  $min=40$  l/sek si dhe kombinimi me marrjes e ujit edhe nga burimi i Merkos ashtu edhe nga pus shpimi ne Vargalat mundesi te cilat jane pasqyruar ne variantet e meposhteme

Nga krahasimi i varianteve del se ekziston nje diference e madhe ne peshen e tubave ~128 ton qe vjen si rezultat i parashikimit te dy linjave  $\Phi 200m/m$  dhe  $\Phi 80m/m$

## **5.2 HARTIMI I PROJEKTIT TE RI DHE ZGJIDHJA E SKEMES PERFUNDIMTARE**

### **1. Varianti i pare**

Ky variant perfshin dy zgjidhje.

- Zgjidhja e pare

me furnizimin me uje nga burimi i Merkos, me nje stacion pompimi dhe me nje nyje klorifikimi . Ne stacion do te kemi dy grupe pompash . Nje grup do te sherbeje per furnizimin e Qesaratit , Karroqit dhe partitorit 3 ndersa grupi tjetër do te furnizoje partitorin 1. Nga partitori 3 do te furnizohet depoja e perbashket per Ninatin dhe Markatin si dhe depoja e Janjarit . Nga partitori 1 do te kemi furnizimin e Pandelejmonit , Komatit , Graves si dhe te linjes ne drejtim te partitorit 2 . Gjate kesaj linje furnizohen Liazar, Kalcat, Koder, Libadhja dhe partitori nr.....

Nga partitori 2 dalin kater linja te vecanta, njera per Lefter Talo dhe Sopik., tjetra Pllaka, Qemere , tjetra kullurice , Tale dhe tjetra dobra dhe Vagalat.

- Zgjidhja e dyte .

Ka ndryshim nga e para sepse nga partitori 1 del lipi-kalcat dhe linja tjetere qe para se t shkoje ne partitorin 2 degezohet ne nyjen H per te furnizuar Livadhjen dhe Kodren .Shperndarja e metejshme ngelet e njejtje me zgjidhjen e pare. Si eergji elektrike te dyja zgjidhjet e kane njelloj ndersa zjidhja e dyte ka 10.7tonme pak tubacione prandaj si zgjidhje me te mire pranojme zgjidhjen e dyte.

### **2. Variant ii II-te.**

Furnizimi behet nga burimi i Merkos me dy grupe pompash. Njeri grup furnizon partitorin 3 dhe Karroqin ndersa grupi tjetere furnizon partitorin 1 me degezimet ne B dhe C per ne Qesarat dhe Pandelejmon dhe Komat. Pastaj nga partitori 1 me vetrrjedhje shperndan per furnizim te metejshem.

### **3. Variant ii III-te**

Furnizimi behet nga burimi i Merkos me dy grupe pompash. . Njeri grup furnizon partitorin 3 dhe Karroq ndersa tjetri depon Qesarat. Nga depo Qesarat me vetrrjedhje e cojme ne partitorin 1 prej nga bejme shperndarjen me veterrjedhje si ne variantin e pare ne zgjidhjen e dyte.

### **4. Varianti IV**

Furnizimi behet nga pusi Vagalat me dy grupe pompash. Njeri per furnizimin e Dobros dhe Vagalat. Tjetri me degezim ne pike S, nga njera ane per te furnizuar partitorin 3 dhe per te shperndare ne Markat , Ninat ketej me veterrjedhje e cojme ne partitorin 2 duke bere furnizimin edhe ne degen H. Nga partitori 2 dalin me dy linja me veterrjedhje per furnizimin e metejshem. Edhe ne kete rast do te kemi nje stacion pompimi dhe nje nyje klorifikimi.

### **5. Varianti V.**

Ne kete variant furnizimi kemi dy pika furnizimi. Me furnizimin nga pusi Vagalat furnizojme Dobra, Vagalatin dhe partitorin 2. Nga partitori 2 me veterrjedhje dalin dy linja per te furnizuar njera Pllake e Qemere e tjetra Kullurice e Talo , me furnizimin nga burimi i Merkos me nje grup pompash dhe me nje tredegezim ne nyjen Z bejme furnizimin e pjeses tjetere.

Nje degezim shkon ne Karroq nje tjetere ne partitorin 3 per te furnizuar Markat , Ninat , Janjar dhe nje tjetere per te furnizuar pjesen tjetere deri ne koder.

Ne kete variant do te kemi dy stacione pompimi dhe dy nyje klorifikimi. Gjithashtu eshte paraqitur edhe nje nenvariant i variantit te pare me nje rritje prej 25 l/dite (banore) si shtese per nevojat e prodhimit shtese per kushtet kur nuimkemi te dhena te specifikuara nga rrethi. Ne kete variant eshte ruajtur po ajo skeme si ne variantin e pare por me nje prurje totale prej  $q=26.22$  l/sek.

Ndermjet pese varianteve eshte bere krahasimi me treguesin e shpenzimeve minimum. Te dhenat tekniko-ekonomike jane permbledhur ne tabelen nr 1.

Duke gjyjuar mbi dhenat tekniko-ekonomike te varianteve si edhe ten je shfrytezimi sa me te mire te skemes kemi pranuar si skeme me te pershtatshme ate te variantit te pare.

N.q.se do te kemi probleme ndertimi dhe shfrytezimi me linjen 1-H-2 atehere do te pranojme variantin e pare.

Zgjidhjen e pare gje e cila do te percaktohet gjate rikonjksionit qe do te behet per projektin.

- **VARIANTI PERFUNDIMTAR**

## UJËSJELLESIA RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.

*Pra, perfundimisht nga hartimi i projekt zbatimit dhe investigimet ne terren u arrit ne prfundimin e skemes se alternuar pra nga Burimi I Merkos deri ne fshatin Pandejlemon me ngritje mekanike duke furnizuar fshatart Karroq, Ninat Markat, Qesarat Grava, Pndejlemon Komat Llazarat ku te gjithë keto fshatra furnizohen me presion nga stacioni i pompimit paras e uji te shkoje ne depon Pandejlemon dhe nga ketu pastaj uji shperndahet me veterrjedhje ne fshatrat Livadhja Kodra Kullurica Lefter Talo, Sopiku etj\*Shih planvendosjen e projektit\*.*

*Sasia e ujit qe do te perdoret eshte 32 l/s 27nga stacioni kryesor dhe 6 l/s nga stacioni dytesor per fshatrat Karroq dhe Ninat Markat, kurse fshatrat e tjere do te furnizohen nga stacioni i pompimit kryesor me dy pompa ku njera eshte reserve.*

### 6. LLOGARITJET HIDRAULIKE TË SISTEMIT

#### 6.1 PËRCAKTIMI I LLOJIT DHE NUMRIT TË PËRDORUESVE

Popullsia llogaritesë nevojitet te dihet sepse ne kerkojme nje funksionim normal te vepres tone (pra te ujesjellsit) edhe per 25 vitet e ardhshme prandaj duhet qe te dime popullsinë pas 20 vjetesh gje e cila mund te llogaritet me ane te formules empirike :

$$N_n = N * ( 1 + 0,01 * p )^n$$

Ku:  $N_n$  - numri i banoreve te qendres se banuar pas n vjetesh;

$N$  - numri i banoreve ne kohen e projektimit - ( banorë ) ;

$p$  - rritja natyrore e popullsisë ne perqindje - (2.0 % ) ;

$n$  - numri i viteve per periudhen llogaritesë - ( 25 vjet ) .

Nr.	Te dhenat	Njesia	Viti 2019	Viti 2024	Viti 2029	Viti 2034	Viti 2039	Viti 2044
<b>1</b>	<b>Te dhenat e popullsisë</b>							
1.1	Popullsia	nr.	9,020	9,959	10,995	12,140	13,403	14,798
1.2	Instutucione shkollore (nxenes)	nr.	4	4	4	4	4	4
1.3	Qendra shendetesore (shitreter)	nr.	5	5	5	5	5	6
1.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	nr.	10	10	10	11	11	11
1.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	nr.	14	14	15	15	15	15
1.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	nr.	10	10	10	11	11	11
1.7	Hotele (shitreter)	nr.	1	1	1	1	1	1
1.8	Siperfaqe te gjelberuara	m <sup>2</sup>	1,200	1,260	1,323	1,389	1,459	1,532
1.9	Fabrika te medha	nr.	2	3	4	5	6	7
<b>2</b>	<b>Normat e konsumit te marra ne llogaritjen e nevojave per uje</b>							
2.1	Konsumi ditor per popullsinë	l/p/d	150	150	150	150	150	150
2.2	Konsumi ditor per nxenesit	l/nx/d	14	14	14	14	14	14

**UJËSJELLESI RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

2.3	Konsumi ditor per te pacient	l/pac/d	80	80	80	80	80	80
2.4	Konsumi ditor per punonjes	l/pun/d	12	12	12	12	12	12
2.5	Konsumi ditor per femijet kop.cer	l/fem/d	60	60	60	60	60	60
2.6	Konsumi ditor per klient	l/kli/d	20	20	20	20	20	20
2.7	Konsumi ditor per shtrat	l/shtr/d	10	10	10	10	10	10
2.8	Konsumi ditor per m <sup>2</sup>	l/m <sup>2</sup> /d	14	14	14	14	14	14
2.9	Konsumi ditor per nje fabrike	m <sup>3</sup> /d	0	0	0	0	0	0
<b>2.1</b>	<b>Humbjet e ujit (% e prodhimit)</b>	<b>%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>
<b>2.2</b>	<b>Koeficientet e jo-uniformitetit</b>							
2.2.1	Koef. Jounif. ditor $f_d = 3.9 \times E^{-0.0752}$	-	1.744	1.744	1.744	1.744	1.744	1.744
2.2.2	Koef. Jounif. orar $f_h = 18.1 \times E^{-0.1682}$	-	2.993	2.993	2.993	2.993	2.993	2.993
<b>3</b>	<b>Kerkesa ditore per uje (Total) NETO</b>	<b>m<sup>3</sup>/d</b>	<b>1,371</b>	<b>1,513</b>	<b>1,670</b>	<b>1,842</b>	<b>2,033</b>	<b>2,243</b>
3.1	Popullsia	m <sup>3</sup> /d	1,353.00	1,493.82	1,649.30	1,820.96	2,010.49	2,219.74
3.2	Instutucione shkollore (nxenes)	m <sup>3</sup> /d	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06
3.3	Qendra shendetesore (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.40	0.41	0.42	0.42	0.43	0.44
3.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	m <sup>3</sup> /d	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13	0.13
3.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	m <sup>3</sup> /d	0.84	0.86	0.87	0.89	0.91	0.93
3.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	m <sup>3</sup> /d	0.20	0.20	0.21	0.21	0.22	0.22
3.7	Hotele (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
3.8	Siperfaqe te gjelberuara	m <sup>3</sup> /d	16.80	17.64	18.52	19.45	20.42	21.44
3.9	Fabrika te medha	m <sup>3</sup> /d	-	-	-	-	-	-
<b>4</b>	<b>Kerkesa mesatare ditore per uje (Total) BRUTO</b>	<b>m<sup>3</sup>/d</b>	<b>1,714</b>	<b>24</b>	<b>2,087</b>	<b>2,303</b>	<b>2,541</b>	<b>2,804</b>
4.1	Popullsia	m <sup>3</sup> /d	1,691.25	1,867.28	2,061.62	2,276.20	2,513.11	2,774.67
4.2	Instutucione shkollore (nxenes)	m <sup>3</sup> /d	0.07	0.07	0.07	0.07	0.08	0.08
4.3	Qendra shendetesore (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.50	0.51	0.52	0.53	0.54	0.55
4.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	m <sup>3</sup> /d	0.15	0.15	0.16	0.16	0.16	0.17

**UJËSJELLESI RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

4.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	m <sup>3</sup> /d	1.05	1.07	1.09	1.11	1.14	1.16
4.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	m <sup>3</sup> /d	0.25	0.26	0.26	0.27	0.27	0.28
4.7	Hotele (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
4.8	Siperfaqe te gjelberuara	m <sup>3</sup> /d	21.00	22.05	23.15	24.31	25.53	26.80
4.9	Fabrika te medha	m <sup>3</sup> /d	-	-	-	-	-	-
<b>5</b>	<b>Piku i Kerkeses Ditore</b>	<b>m<sup>3</sup>/d</b>	<b>2,990</b>	<b>3,299</b>	<b>3,640</b>	<b>4,016</b>	<b>4,431</b>	<b>4,890</b>
5.1	Popullsia	m <sup>3</sup> /d	2,949.5 4	3,256.5 3	3,595.4 7	3,969.6 9	4,382.8 6	4,839.0 3
5.2	Instutucione shkollore (nxenes)	m <sup>3</sup> /d	0.12	0.12	0.13	0.13	0.13	0.13
5.3	Qendra shendetesore (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.87	0.89	0.91	0.93	0.94	0.96
5.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	m <sup>3</sup> /d	0.26	0.27	0.27	0.28	0.28	0.29
5.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	m <sup>3</sup> /d	1.83	1.87	1.91	1.94	1.98	2.02
5.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	m <sup>3</sup> /d	0.44	0.44	0.45	0.46	0.47	0.48
5.7	Hotele (shtreter)	m <sup>3</sup> /d	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
5.8	Siperfaqe te gjelberuara	m <sup>3</sup> /d	36.62	38.46	40.38	42.40	44.52	46.74
5.9	Fabrika te medha	m <sup>3</sup> /d	-	-	-	-	-	-
<b>6</b>	<b>Piku i Kerkeses Orare</b>	<b>m<sup>3</sup>/h</b>	<b>214</b>	<b>236</b>	<b>260</b>	<b>287</b>	<b>317</b>	<b>350</b>
6.1	Popullsia	m <sup>3</sup> /h	210.91	232.86	257.10	283.86	313.41	346.03
6.2	Instutucione shkollore (nxenes)	m <sup>3</sup> /h	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
6.3	Qendra shendetesore (shtreter)	m <sup>3</sup> /h	0.06	0.06	0.06	0.07	0.07	0.07
6.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	m <sup>3</sup> /h	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
6.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	m <sup>3</sup> /h	0.13	0.13	0.14	0.14	0.14	0.14
6.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	m <sup>3</sup> /h	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03
6.7	Hotele (shtreter)	m <sup>3</sup> /h	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
6.8	Siperfaqe te gjelberuara	m <sup>3</sup> /h	2.62	2.75	2.89	3.03	3.18	3.34
6.9	Fabrika te medha	m <sup>3</sup> /h	-	-	-	-	-	-
<b>7</b>	<b>Max. i Prurjes se trasmetimit, magazinimi ose (Q) nga burimi</b>	<b>l/s</b>	<b>20</b>	<b>22</b>	<b>24</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>32</b>
7.1	Popullsia	l/s	19.57	21.61	23.86	26.34	29.09	32.11

**UJËSJELLESI RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

7.2	Instutucione shkollore (nxenes)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7.3	Qendra shendetesore (shtreter)	l/s	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
7.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	l/s	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
7.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7.7	Hotele (shtreter)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7.8	Siperfaqe te gjelberuara	l/s	0.24	0.26	0.27	0.28	0.30	0.31
7.9	Fabrika te medha	l/s	-	-	-	-	-	-
<b>8</b>	<b>Max. i Prurjes ne rrjetin shperndares</b>	<b>l/s</b>	<b>59</b>	<b>66</b>	<b>72</b>	<b>80</b>	<b>88</b>	<b>97</b>
8.1	Popullsia	l/s	58.59	64.68	71.42	78.85	87.06	96.12
8.2	Instutucione shkollore (nxenes)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
8.3	Qendra shendetesore (shtreter)	l/s	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
8.4	Inst. Buxhetore+private (punonjes)	l/s	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
8.5	Cerdhe+Kopshte femijesh (femije)	l/s	0.04	0.04	0.04	0.04	0.04	0.04
8.6	Bare+ristorante+dyqane (klient)	l/s	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
8.7	Hotele (shtreter)	l/s	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
8.8	Siperfaqe te gjelberuara	l/s	0.73	0.76	0.80	0.84	0.88	0.93
8.9	Fabrika te medha	l/s	-	-	-	-	-	-
<b>9</b>	<b>Prurjet</b>							
9.1	Vol. ditor	m <sup>3</sup> /d	2,392	2,639	2,912	3,213	3,545	3,912
9.2	Vol. orar	m <sup>3</sup> /h	171	189	208	230	253	280
9.3	Pr. Ditore qe kerkohet	l/s	15.87	17.51	19.32	21.32	23.53	26
9.4	Humbjet 20%	%	274	303	334	368	407	449
9.5	Prurja mes.	l/s	19	21	23	26	28	<b>31.15</b>
9.6	Pr. Shperndarese	l/s	57.01	62.90	69.40	76.58	84.50	<b>93.24</b>

*Dy fshatrat Zminec dhe Grazhdan nuk mund te perfshihen ne skemen e e furnizimit me uje nga burimete merkos per faktin se ka nje largesi te konsiderueshme nga burimi i Merkos ku linja e*

*jashteme ose rrjeti per kete fashatra del jo rentabel dhe kesisoj sugjerojme qe te shihen burime alternative te furnizimit ne uje te ketyre dy fshatrave te vegjel.*

## **6.2 LLOGARITJA E KËRKESËS PËR UJË**

Nga llogaritjet e bera, duke u mbeshtetur ne te dhenat e detyres se projektimit, normave te konsumit te ujit, perspektiven 25 vjeçare te zhvillimit te fshatrave , si dhe rritjen e zonave per objektet social kulturore, jane pranuar te dhenat e me poshtme per llogaritjen e sasise se ujit.

Normat e e perdorimit te ujit i kemi pranuar perkatesisht per 150 l/dper banore per bizneset 300 l/d cezma publike 200 l/d shkolla 40 l/d lulishte 2 l/d etj dhe koeficient  $Ko=2$ . Popullsia totale per te gjithë fshatrat shkon rreth 9020 banore sipas te dhenave te pushtetit lokal. Ne baze te llogaritjeve per te plotësuar novojat me uje te pijshem nga burimet Merkos duhen rreth **33 l/s**.

- **Pefundimisht prurja llogaritesë per secilin nga sistem me presion nga pompat do te jete:**

1. *Stacioni pompave nr.1 qe furnizon rezervuarin e perbashket e fshatrave Ninat -Markat si pjese administrative e Bashkise Konispol, prurja 3.5 l/s qe furnizon depot e fshatit Karroq si pjese administrative e e bashkise finiq prurja 2.2 l/s  $3.5+2.2=5.7$  l/s*
2. *Stacioni i pompave nr.1 qe furnizon fshatrat e tjere me stacion pompimi me prurje 34 l/s ku deri ne rezervuaret Pandejlemon , Qesarat e Grave do te furnizohet me presion nga stacioni pompit 1 perkatesisht ne stacionin e pompimit nr.2-3. Qesarat dhe grave do te marin uje ne te njejten linje ne sasine perkatesisht Qesarati 2.47 l/s dhe Grava 2.65 l/s ne total **5.12 l/s nga stacioni nr.3**.*
3. *Ndersa nga Rezervuari shperndares i Pandejlemonit mer uje nga **stacioni nr.2** do te furnizohet ne kuoten 350 m mnd dhe me pas do te kemi sistem me difrence gjeodezike ku lind presioni hidrostatik pasi te gjitha rezervuaret e fshatrave si:  
1.Komati, 2.Kalcati 3.Llazati, 4.Livadhja, 5.Kodra, 6.Kullurica, 7.L.Talo, 8.Sopiku, 9.Vagalati jane me poshte se kuota 350 m m.n.d dhe mund te furnizohen me rrjedhje me presion nga rezervuari Pandejlemon, ku prurja dalese nga ky rezervuar grumbullues do te jete  $33-5.12=27.88$  l/s pronojme nje prurje prej 28 l/s.*

Shih skemen hidraulike bashkengjitur ne fletet e projekt zbatimit.

### **6.2.1 Kërkesa për ujë kundër zjarrit**

Kërkesa për ujë rekomandohet nga kodet si dhe ligjet për mbrojtjen nga zjarri. Mbrojtja nga zjarri i ofrohet banorëve varësisht madhësisë së objekteve, ajo i ofrohet në brendi të objektit ose në rast të shtëpive të vogla duke furnizuar nga jashtë të lidhur në rrjetin kryesor. Pos banorëve mbrojtja nga zjarri i ofrohet dhe objekteve të rëndësishme si: shkolla, institucione, zona industriale etj.

Zonat e mbrojtura nga zjarri klasifikohen në bazë të riskut (4):

*Zonë me risk të lartë*

Janë pjesë ku rreziku nga zjarri dhe shpërndarja e tij është e lartë, në institucione, objekte me përqëndrim të njerëzve, si dhe zona industriale apo depo me rrezik të lartë nga zjarri si dhe objekte banimi me katër ose më shumëkatë.

*Zonë me risk mesatarë*



Këto janë zona me rrezik mesatar të rënies dhe shpërndarjes së zjarrit ku bëjnë pjesë zona industriale, objekte banimi jo më të larta se tre kate.

*Zonë me risk të ulët*

Janë zona ku rrëziku për rënjen e zjarrit dhe shpërndarjes është i ulët. Në këtë kategori janë katër grupe:

- Grupi 1: Objekte banimi ku një kat duke përfshirë edhe sipërfaqet e jashtme si ballkoni është më shumë se 200 m<sup>2</sup>.
- Grupi 2: Objekte banimi ku një kat duke përfshirë edhe sipërfaqet jasht si ballkoni varion nga 100 m<sup>2</sup> deri 200 m<sup>2</sup>.
- Grupi 3: Objekte banimi ku një kat duke përfshirë edhe sipërfaqet jasht si ballkoni është më e vogël se 100 m<sup>2</sup> por jo më e vogël se 55 m<sup>2</sup>. Në këtë grup hyjnë dhe shtëpitë me kosto të lirë dhe distancë të konsiderueshme nga objektet afër si dhe në ato objekte ku ndarjet e dhomave bëhen me material rezistues ndaj zjarrit me minimum 1 orë.
- Grupi 4: Objekte banimi ku një kat duke përfshirë edhe sipërfaqet jasht si ballkon është më e vogël se 55 m<sup>2</sup>. Në këtë grup hyjnë dhe shtëpitë me kosto të lirë dhe distancë të konsiderueshme nga objektet afër si dhe në ato objekte ku ndarjet e dhomave bëhen me material rezistues ndaj zjarrit me minimum 1 orë.

Normat e projektimit të sistemit kundër zjarrit si: kohëzgjatja e zjarrit, presioni minimal në hidrant, prurja e nevojshme për shuarjen e zjarrit dhe pozicionimin e hidranteve do i paraqesim në tabelat në vijim (4):

**Tabela 14: Kohëzgjatja për projektimin e prurjes kundër zjarrit (4)**

<b>Kohëzgjatja për projektimin e prurjes kundër zjarrit</b>	
Kategoria e riskut nga zjarri	Kohëzgjatja për projektimin e prurjes kundër zjarrit (orë)
Risk i lartë	6
Risk mesatar	4
Risk i ulët grupi 1	2
Risk i ulët grupi 2	1
Risk i ulët grupi 3	1
Risk i ulët grupi 4	-

**Tabela 15: Prurja dhe kriteret e vendosjes së hidranteve (4)**

<b>Prurja e projektimit për ujin kundër zjarrit</b>			
Kategoria e riskut nga zjarri	Minimumi e prurjes për zjarrë (l/min)	Numri maksimal i hidranteve me shkarkim në të njëjtën kohë	Presioni minimal në hidrant (m)
Risk i lartë	12,000	Të gjitha hidrantet me radius prej 270 m nga	15

**UJËSJELLESI RAJONAL BASHKIA FINIQ (RRJETI I JASHEM NGA BURIMET E MERKOS). RAPORTI TEKNIK.**

Risk mesatar	6,000	zjari	15
Risk i ulët grupi 1	900	1	7
Risk i ulët grupi 2	500	1	6
Risk i ulët grupi 3	350	1	6
Risk i ulët grupi 4	-	-	-
<b>Kriteret për vendosjen e hidrantit</b>			
Kategoria e riskut nga zjarri	Pozita e hidrantit		
Risk i lartë	Distance deri: 120 m maksimum		
Risk mesatar	Distance deri: 180 m maksimum		
Risk i ulët grupi 1	Distance deri: 240 m maksimum		
Risk i ulët grupi 2	Distance deri: 240 m maksimum		
Risk i ulët grupi 3	Distance deri: 240 m maksimum		
Risk i ulët grupi 4	Në vende të përshatshme me diametër minimal 75 mm		

Formë tjetër e llogaritjes së prurjes për mbrojtjen nga zjarri në funksion të numrit të banorëve mund të bëhet dhe duke shfrytëzuar formula të ndryshme si:

Zona e cila do të furnizohet me ujë nga kushtet që u përmendën më sipër mund të vlerësohet si zonë me risk të ulët grupit 3 të këtij risku. Nga tabela marrim vlerat për llogaritjen dhe projektimin e sistemit duke përfshirë dhe mbrojtjen nga zjarri. Ndërsa për objekte të veçanta si shkollë apo spitale do të furnizohen me sisteme të veçanta nga sistemi i furnizimit me ujë.

Kohëzgjatja për projektimin e prurjes kundër zjarrit: 1 ore

Prurja e projektimit për ujin kundër zjarrit  $Q^{dzj} = 350 \text{ l/min} = 5.8 \text{ l/sek}$

Numri maksimal i hidranteve me shkarkim në të njejtën kohë: një zjarr. Por duke marr parasysh sipërfaqen e madhe ku gjenden këto 16 fshatra atëherë pranojmë se mund të ndodhin tre zjarre të njëkohësishme brenda sistemit. Kontrolli që do bëhet për presionin minimal të krijuar në hidrante gjatë furnizimit me ujë kundër zjarrit, presioni duhet të jetë më i madh se ai minimal edhe gjatë furnizimit me ujë të hidranteve në pikat më të disfavourshme.

Kriteret për vendosjen e hidrantit: Distancë deri 240m maksimum

Diametrin për hidrant e pranojmë 100mm duke pasur parasysh dhe presionin minimal që do krijohet në hidrant të jetë më i vogël se 6m.


## **7. STACIONI I POMPIMIT**

### **7.1 STACIONI EKZISTUES PRANE BURIMIT TE MERKOS**

Stacioni aktual perbehet nga keto nen vepra:

- *Vepra e marrjes rreth 30 m larg stacionit te tij 50-60 l/s dimensione ne plan 21\*4 m dhe thellesi 1.3 m*
- *1-Depozite grumbulluese e thithjes se ujit nga pompat 60 m<sup>3</sup>*
- *1- Depo e klorifikimit pa nyje 1- 60 l/s*
- *1-Pusete shperndarese*
- *1-Pusete manovrimi*
- *1-Dhome sherbimi per rrojet e deamortizuar*
- *Rrethim me tel me gjemba e deamortizuar*

Te gjitha keto nen vepra ishin te deamortizuar nga ana funksionale, zona ishte kethyre ne qender blegtorale dhe ne mnyre urgjente kerkohet qe te evadohen te gjitha kafshet e e siguruara aty si vendstrehim. Terreni ishte I mbushur me uje nga mos funksionimi I neveprave te kullimit she sistemit te tij.



*Fig 1 Foto nga stacioni pompimit ekzistues*



Fig 3 Pamje nga kaptazhi I burimit te Merkos



Fig.3 Pamje nga puseta shperndarese

## **7.2 STACIONI I RI DHE REHABILITIMI I ATIJ EKZISTUESLLOGARITJA E POMPAVE NE STACIONIN E POMPIMIT**

Stacioni i pompimit sipas pompes se zgjedhur do te kete nje kapacitet ngrites ne rezervuaret perketes. Stacioni i pompimit per shkak te hapesires se disponueshme duhet te projektohet per te instaluar dy pompa horizonatle ose vertikale te ngjajshme me ato ekzistuese. Per shkak te kushteve me te mira te instalimit ne kete projekt jane preferuar pumpat centrifugale vertikale. Menyra e operimit te pompave do te jete nje ne pune dhe nje rezerve.Pompat do te jene nje faze, me spirale te ndare aksiale per instalim horizontal. Nje pamje e tipit te pompes jepet ne figuren 9-1.




Figure 7-1 Pmaje e pompes nje faze me spirale te ndare aksiole per instalim horizontal

Tubot e thithjes dhe tubot e shkarkimit si dhe saracineskat qe i shoqerojne (saracineskat e kontrollit dhe te mbylljes se prurjeve, xhuntut e montim/cmontimit, etj) jane instaluar ne dhomen e thate te stacionit te pompimit te rrethuar nga depoja grumbulluese e thithjes se ujit.

Tubot e thithjes jane tre ekzistuese te instaluar nga te cilat vetem dy anesoret do te perfshihen ne projektin aktual te stacionit te pompimit. Tubi i thithjes se mesit do te mbetet i taposur dhe nuk do te perdoret. Pamje e tubove thithes ekzistues jepen ne figuren 9-2 me poshte:

Skema e furnizimi do te jete e njejta ne thelb por me ndryshimin qe do te kemi nje pompe me shume pasi zona e Qesarat Grave do te furnizohet me grup te vecante pompash dhe jo me nje pompe te vetme qe ka qene e perbashket me ate te rezervuarit shperndares te Pandejlemonit e me tej.

Sic thame dhe me siper skeme e furnizimit te rrjetit te jashteme eshte skeme e alternaur me ngritje mekanike deri ne fshatin Pandejlemon ne kuoten 350 m nga burimi i Merkos i cili ndoshet rreth kuotes 109 m. ne kete menyre perfthohet nje renien gjeodezike pre 250m. Pruja ne daljete stacionit te pompimit e cila duhet te coje ne kete pike pompa qe ne baze te llogaritjeve hidraulike te projektit per te plotesuar te gjitha nevojat per uje te pijshem.

Ne kete menyre kryejme llogaritjet e pompes pra nxjerrjen e parametrave te saj. Sic thame uji nga kaptaxhi mblidhet ne nje depo ne te cilen xhytet pompa per te cilen po japem llogaritjet si me poshte. Llogaritjet jepen per nje pompe por gjithmone ne te till raste vihet ne pune e dhe nje pompe rezerve qe te mos krijoje avari ne regjimin e furnizimit me uje te rajonit perreth aq me shume kur behet fjale per nje zone me popullsi te konsiderueshme e cila varet totalisht nga puna stacionit te pompimit. Nga llogaritjet na rezulton qe:

Brenda sistemit te stacionit te pompimit do te kemi 3 grupe pompash perbere keto dhe nga nje pompe rezerve

1. Grupi i pompave nr.1 deri ne rezervuarin shperndares Pandejlemon si dhe ne depon Qesarat qe furnizon fshatrat e tjere me stacion pompimi me prurje  $Q=33$  l/s ku deri ne stacioni i pompimit nr.2  $H_p=420$ m. 2 pompa elektromekanike (1 ne pune 1 rezerve)

**Kjo linje ne progresivin 4500 meter ndahte ne dy dege ate te ta pandejlemonit dhe te Qesaratit te cila jane ne te njeten kuote 350 m mnd**


2. *2. Grupi i pompave (ne te njejtën godine) per ne Ninat –Markat- si pjese administrative e Bashkise Konispol, dhe Karroq Bashkia Finiq, prurja rreth  $Q=5.8$  l/s.  $H_p= 580$ m. 2 pompa elektromekanike (1 ne pune 1 rezerve)*

**1. STACIONI I POMPIMIT NR.1 FURNIZON STACIONIN  $Q=33$  lit/sec;  $H = 420$  m**

Pompe Vertikale me shume shkalle (9 helika) me te gjitha pjeset ne kontakt me ujin prej Celik Inox EN 1.4401, gjithashtu edhe baza e pompes prej Celik Inox EN 1.4408, Motorri 3 fazor i eficences se larte IE3; 3x380-420D/660-725Y V 110 kW; Mbrotje termike PTC; Kurba e Punes sipas ISO9906:2012 3B; Klasa e hermetizimit IP55 (IEC 34-5); Secila Pompe jep  $Q=34$  lit/sec;  $H = 420$  m, dhe 2 Pompat mund te lidhen ne paralel

Panel Komandimi per 2 Pompat i perbere nga 2 Inverter 2x110 kW; IP21 per komandimin, monitorimin dhe mbrojtjen e pompave, kompletuar me Njesine e Komandimit CU352 qe ka ekran LCD, butona per konfirgurim dhe perpunim te dhenash, mundesi komunikimi me Sistemin Scada ose PLC me ane te moduleve te komunikimit CIM me ane te protokollit Modbus RTU. Njesia mundeson mbajtjen e presionit konstant, mbrojtjen nga puna pa uje (duhet sensor ne thithje te pompes), regjistrim alarmesh.






Projekti teknologjik i pompes nga grundfos.

## 2. STACIONI I POMPIMIT NINAT MARKAT Q=6lit/sec; H = 580 m

### SP 30-43 - 13A45343

kjo pompe jep 6 lit/sec me H=580 m; P=100 kW ; Yll/Trekendesh (S/D) ; komplet Celik Inox ; 2840-2860-2870 rpm ; Motori me diameter : 6 Inch ; me valvol mos-kthimi te inkorporuar ; dalje DN80 me fllanxe ; izolimi IP68 bashke me aksesoret per instalim horizontal brenda depos



### 7.3 PAJISJET E FRUNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE QE DUHEN

Pajisjet e furnizimit me energji elektrike ne stacionin e pompimit jane:

- Kabllot e furnizimit me energji nga panelet per ne pompat e stacionit te pompimit
- Panelet e komandimit te pompave,
- Transformatori dhe
- Furnizimi i jashtem is stacionit te pompimit

Nevoja per piken e lidhjes ka qene rreth 300 kw ndersa tani mund te arrije deri ne 400 kw pasi kerkesa per uje eshte me e larte tani krahasuar 20 vite me pare kur eshte ndertuar projekti ne vitin 1988.

## **8. ANALIZA E GJENDJES SE PAQENDRUESHME TE SISTEMIT**

Fenomeni i gjendjes se paqendrueshme mund te percaktohet si nje gjendje ne nje sistem hidraulik me ndryshim te shpejt te shpejtesise, prurjes, presionit dhe variablave te tjere hidraulike.

Grushti hidraulik, si nje shembull i rrjedhjes se paqendrueshme ne nje sistem hidraulik ndodh ne rastet e meposhtme:

- Mbyllje e menjehershme e nje saracineske ose valvole, ndalim i menjehershem i pompes, etj
- Fillim i menjehershem i prurjes – procedura e fillimit te operimit (hapja e nje saracineske, fillimi I menjehershem I punes se pompes, etj

Cdo ndryshim ne prurje con ne lekundje te presionit ne nje sistem. Gjendja e paqendrueshme e nje sistemi hidraulik mund te ndodh ne pergjithesi per cdo aresye qe mund te grupohen si me poshte:

- Aksidentale dhe e pakontrolluar jashte kontrollit te stafit te operimit (p.sh. ndalja e punes se pompes)
- E kontrolluar nga stafi i operimit (p.sh. fillimi dhe fikja e pompes ne nje stacion pompimi, mbyllja ose hapja e saracineskave

Grushti hidraulik shkakton rritje ose zvogelim te presionit ne sistemin hidraulik te satcionit te pompimit.

Masa mbrojtese specifike perdoren ne pergjithesi per te mbrojtur pajisjet dhe tubacionet nga demtimi per shkak te grushtit hidraulik.

Nese pergjigjja e sistemit kundrejt grushtit hidraulik nuk arrin te perballoje presionet maksimale dhe minimale te shkaktuara nga ky fenomen atehere sistemi duhet te riprojektohet ose pajisje te kontrollit duhet te sigurohen dhe sistemi duhet te analizohet perseri. Kjo procedure duhet te perseritet derisa sistemi ti pergjigjet pasojave te fenomenit te grushtit hidraulik.

Qellimi i kontrollit te grushtit hidraulik eshte te ndaloje transformimin e energjise kinetike ne energji te deformimit. Kjo mund te behet nga njera ose kombinime te disa metodave te dhena me poshte:

- Grumbullimi i energjise
- Optimizimi i karakteristikave te mbylljes se saracineskes
- Instalimi i sistemeve te valvolave te kunderta dhe te ajrimit
- Optimizimi i strategjise se projektuar per te kontrolluar sistemin e tubacioneve
- Etj,

Me dhoma presioni (dhoma ajri) dhe kulla ekuilibri, energjia është magazinuar si energji presioni. Kur një volant instalohet, energjia e grumbulluar merr formën e energjisë rrotulluese.

Një grafik i përshtatshëm për hapjen dhe mbylljen e valvolave duhet të llogaritet dhe verifikuar në kuptimin e një analize të rrjedhjes së paqendrueshme dhe bazuar në karakteristikën e valvolës.

Përgjithësisht, valvolat e ajrit nuk duhet të përdoren si pajisje mbrojtëse nga grushti hidraulik derisa të gjithë zgjidhjet e tjera janë konsumuar. Aresyet janë:

- Ato kërkojnë mirëmbajtje të rregullt periodike
- Nëse vendoset në pozicion të gabuar ose montuar jo në mënyrë korrekte, ato mund të rëndojnë lekundjet e presionit në vend të zbutjes së tij
- Në rrethana të caktuara, operimi i sistemit mund të jetë i kufizuar, sepse ajri që është i grumbulluar në sistem duhet të hiqet perseri.
- Menaxhimi i ujërave të ndotur na kërkon projekte speciale

Fenomeni i grushtit hidraulik tradicionalisht është përshkruar nga ekuacionet e rrjedhjes së paqendrueshme një-dimensionale në tubacione dhe ekuacionet që përshkruajnë elementet e kushteve kufitare (rezervuar, saracineske, kulla ekuilibri, pompa/turbina)

Grushti hidraulik është transmetimi i vales së presionit përmjet një tubacioni që rezulton nga ndryshimi në shpejtësinë e rrjedhjes.

Ekuacionet e thjeshtëzuar të vazhdueshmerisë dhe momentit, të përshtatshme për aplikime inxhinierike të cilat janë zgjidhur, për të llogaritur rrjedhjen e lengut në tubacione janë:

$$\frac{\partial H}{\partial t} + \frac{a^2}{gA} \frac{\partial Q}{\partial x} = 0 \quad (1)$$

$$\frac{\partial H}{\partial x} + \frac{1}{gA} \frac{\partial Q}{\partial t} + \frac{f|Q|}{2gDA^2} = 0 \quad (2)$$

Ku:

H – Lartësia piezometrike

Q – prurja

A – Shpejtësia e levizjes së vales

D – diametri i tubit

A – sipërfaqja e tubit

g – nxitimi gravitacional

f – Faktori i ferkimit sipas Darcy-Weisbach

x – distanca përmjet tubit

t – koha

Nese ajri eshte prezent ne tubacionin e dergimit ne formen e xhepave te ajrit sistemi mund te perballet me probleme te ndyshme operimi dhe hidraulike te tilla si zvogelim ne kapacitetin e pompes, zhvendosjen e flluskave te ajrit perpara dhe prapa perngjate tubacionit qe ne vetvete do te shkatoje lekundje te presioneve.

Bazuar ne analizen e realizuar opsioni I kontrollit te zgjatur te startimit te pompes eshte me i miri.

Kontrolli i startimit te pompes mund te arrihet ne menytrat e meposhtme:

- Nepermjet instalimit te nje saracineske qe manovrohet nga energjia elektrike ne anen e shkarkimit te pompes
- Nepermjet startimit te pompes nepermjet nje pajisje zbutese graduale (soft starter)
- Nepermjet startimit te pompes nga nje Konverter me frekuence variabel.

Qellimi i kontrollit te startimit te pompes nepermjet njeres nga pajisjet e mesiperme eshte per te siguruar nxitimin e kontrolluar/moderuar te prurjes ne sistem.

Te dyja, startimi i bute dhe Konverteri me frekuence variabel, mund te siguroje kontrollin e kohes se rritjes se nxitimit. Megjithate Konverteri me frekuence variabel ofron nje avantazh kundrejt startimit te bute (soft starter) sepse ai ben te mundur qe nje pomp te punoje ne menyre konstante me nje shpejtesi te zvogeluar.

